



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:020373

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05528259

P.nr.57/2022

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarve: A. Th., nga, të cilin sipas autorizimit e mbron av.Selami Rexhepi, V. S.nga fsh.Muçiverc, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av.Granit Mavriqi dhe I. L. nga, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Shefeqet Rexha, për shkak të se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur paragrafin 2, e në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit A. Th. dhe V. S., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 406, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1314/2021 të datës 04.04.2022, në prezencën e palëve më datën 04.03.2024, publikisht komunikoi, ndërsa më datën 29.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. A. Th., nga babai V., dhe nënës Q., mbiemri i vajzërisë K., i lindur me, në, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

2. V. S., nga babai M., nëna M., e gjinisë K., i lindur me datë, në, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me gjendje të varfër, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

3.I.L., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati S., e ëma Sh., e lindur Xh., i lindur më datë, në, , me nr. personal i, shqiptar, shtetas i Republikës së Serbisë, i pa martuar, i punësuar, ka të kryer fakultetin e edukimit, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Në bazë të nenit 363, parag. 1 nën parag. 1.3 të KPPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

I.

Të pandehurit A.Th. , V. S. dhe I. L.,

Me datë 08.07.2021, rreth orës 12:30 min, në Komunës së Kamenicës, gjatë kontrollës nga Inspektorët e ndërtimit, të komunës së Kamenicës është vërtetuar se, Të pandehurit I. L.si pronar i parcellës dhe A. Th. dhe V. S. si qiramarrës, investitor dhe përgjegjës të drejtpërdrejt, në bashkëveprim kanë filluar punimet duke ndërmarrë veprime që bien ndesh me nenin 14 të ligjit të ndërtimit me nr.04/L-110, ashtu që ka filluar ndërtimin e objektit me konstruksion metalik dhe muratimin e mureve anësore, pa u pajisur me leje ndërtimi, ku Inspektorët komunal me datë 08.07.2021 kishin qenë në vendin e ngjarjes ku edhe e kanë vendosur një tabelë dhe shiritin zyrtar për ndërprerjen e punime dhe kanë përpiluar procesverbal me nr. 24/2021 dhe përkundër kësaj i pandehuri ka vazhduar me punime ashtu që edhe me datë 10.07.2021 Inspektorët Komunal kanë dal ne vendin e ngjarjes dhe kanë konstatuar gjendjen faktike se i pandehuri nuk ka respektuar vendimin e Inspektorëve të Drejtorisë së Inspektoratit Komunal të Kamenicës me nr. 1419 të datës 17.07.2021, për ndërprerjen e menjëhershme të punimeve, por ka vazhduar ekzekutimin e punëve pa ndërprerë në ngritjen e objektit , dhe vendimin e Inspektorëve të Drejtorisë së Inspektoratit Komunal të Kamenicës me nr. 0436 të datës 23.07.2021 për rrënimin e objektit pa leje ndërtimi, por megjithatë i pandehuri ka vazhduar punimet e ndërtimit të objektit afarist duke e hequr-dëmtuar shiritin zyrtar dhe atë pa i përfill dispozitat ligjore për të u pajisur me leje ndërtimi, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tija të kundërligjshme ka rrezikuar sigurinë e përgjithshëm që kanë të bëjnë me rregullat e ndërtimit.

- me çka në bashkëveprim *kishin për* të kryer veprën penale, Ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

II.

Të pandehurit A. Th. dhe V. S.,

Me datë 10.07.2021 e deri më datë 23.07.2021 në kohë të pavërtetuar dhe në vendin e përshkruar si në dispozitivin I të kësaj aktakuze, Të pandehurit A.Th. dhe V. S. si qiramarrës, investitor dhe përgjegjës të drejtpërdrejt, në bashkëveprim kanë vazhduar me punimet duke ndërmarrë veprime që bien ndesh me nenin 14 të ligjit të ndërtimit me nr.04/L-110, ashtu që përkundër paralajmërimit me tabelë nga Inspektorët Komunal të Komunës së Kamenicës dhe vendosjes së shiritit zyrtar me datë 08.07.2021 përreth objektit i njëjti duke dëmtuar shiritin zyrtar ka vazhduar me ndërtimin e objektit me konstruksion metalik dhe muratimin e mureve anësore dhe nuk ka respektuar vendimin e Inspektorëve të Drejtorisë së Inspektoratit Komunal të Kamenicës me nr. 1419 të datës 17.07.2021, për ndërprerjen e menjëhershme të punimeve, por ka vazhduar ekzekutimin e punëve pa ndërprerë në ngritjen e objektit , dhe po ashtu në kundërshtim me vendimin e Inspektorëve të Drejtorisë së Inspektoratit Komunal të Kamenicës me nr. 0436 të datës 23.07.2021 për rrënimin e objektit pa leje ndërtimi, por megjithatë i pandehuri prapë ka vazhduar punimet e ndërtimit të objektit afarist duke e hequr-dëmtuar shiritin zyrtar dhe atë pa i përfill dispozitat ligjore për të u pajisur me leje ndërtimi, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tija të kundërligjshme ka rrezikuar sigurinë e përgjithshëm që kanë të bëjnë me rregullat e ndërtimit,

- me çka në bashkëveprim *kishin për* të kryer veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Pala e dëmtuar Komuna e Kamenicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 453, paragrafi 1, lidhur me nenin 449 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.1314/2021 e datës 04.04.2022, ka propozuar që kundër të akuzuarve: A. Th., V.S. dhe I.L., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur paragrafin 2, e në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit A. Th. dhe V. S., edhe për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 406, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe me rastin e vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarve për datën 22.09.2022, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën por nuk e pranojnë fajësinë.

Pasi që të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë, gjykata i ka njoftuar të njëjtit me të drejtat konform nenit 245, paragrafi 6, nën paragrafi 6.1, 6.2 dhe 6.3 të KPPRK-së Nr.04/L-123.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. Th., av.Selami Rexhepi dhe i akuzuari I.L., brenda afatit ligjor, datën 05.10.2022, kanë paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës, ndërsa kjo gjykatë me Aktvendimin, P.nr.57/2022 të datës 02.11.2022, ka refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata lidhur me rastin ka mbajtur seancë gjyqësore më datën 12.07.2023,15.08.2023, 14.02.2024, në të cilat seanca gjyqësore ka administruar të gjitha provat e propozuara si në aktin akuzues, si dhe provave të tjera të propozuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si të atyre personale, po ashtu edhe provave materiale. Ndërsa në seancën gjyqësore të datës 28.02.2024, Prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri fjalën përfundimtare e paraqiti në formë të shkruar, e të cilën shkurtimisht e elaboroj edhe gojarisht, me ç'rast deklaroj se si përfaqësuese e akuzës mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP.II.nr.1814/2021, të datës 04 Prill 2022, për faktin se gjatë shqyrtimeve të datës 12 Korrik 2023, 15 Gusht 2023 dhe 14 Shkurt 2024, u vërtetu se në veprimet e të akuzuarve, A. Th., V. S. dhe I. L., përmbushen elementet e veprës penale, ndërtim pa leje nga nenin 359 par. 3 lidhur me par. 2 e nenin 31 të KPRK-së dhe në veprimet e të akuzuarve. A. Th. dhe V.S., përmbushen elementet e veprës penale, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi një gjë e tillë u vërtetua përtej dyshimit të bazuar gjatë administrimit të provave personale. Gjendja faktike dhe

fajësia e të akuzuarve të lartcekur u vërtetua nga deklaratat e dëshmitarëve, A. M., cili në shqyrtimin gjyqësor të datës 12 Korrik 2023 ka deklaruar se “i kujtohet se I. L. e ka dhënë tokën me qira, ndërsa në atë pronë të tij dikush tjetër e ka ndërtuar një objekt, por nuk i kujtohet se për çfarë qëllimi e ka dhënë pronën në shfrytëzim, po ashtu nuk e di se a ka pasur të ndërtuar diçka në atë pronë. Po ashtu edhe dëshmitari L. B. në deklaratën e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se data nuk i kujtohet po si inspektor janë dal në vendin e ngjarjes në mes fshatit Karaçevë e Poshtme dhe Novoselle, ku objekti kishte qenë në gjendje fillestare, kishte qenë e qitur një pllakë betoni, disa ceva për konstruksion, ku të njëjtit kishin hartuar një procesverbal, në vendin e ngjarjes nuk kishte qenë askush, mirëpo të dhënat për parcelën i kishin marr në Kadastër në Kamenicë dhe në bazë të dhënave që i kishin poseduar inspektorët, nuk kishte pasur ndonjë kërkesë për tu pajisur me leje nga ana e ndërtuesit të objektit, ku edhe ishte shirituar vendi i ngjarjes, ndërsa herën e dytë, kur janë dalë në vendin e ngjarjes, kanë konstatuar se objekti veç se ishte përfunduar, mirëpo prezent përsëri nuk kishte qenë askush. Vendimin për rrënimin e objektit e kishin dërguar përmes postës tek Sh. K., pasi që asnjëherë askush nuk ishte takuar në vendin e ngjarjes as punëtorët e as ndërtuesit. Dëshmitari F. M., në shqyrtimin gjyqësor të datës 14 Shkurt 2024, deklaroi se data nuk i kujtohet, mirëpo i kujtohet se kishin marrë një informate se në fshatin Karaçevë, është duke u ndërtuar një objekt pa leje, dhe kur të njëjtit ishin dal në vendin e ngjarjes kishin konstatuar se ishte duke u ndërtuar një objekt, mirëpo nuk kishin takuar aty askënd, dhe se nuk kishin asnjë njohuri që investitori apo pronari i tokës ka paraqitur kërkesë për leje ndërtimi, dhe në baze të informatave nga kadastru se kush ishte pronar i asaj prone, të gjitha vendimet ishin adresuar pronarit të tokës. I njëjti gjatë deklaratës ka shtuar se sa herë janë dal në vendin e ngjarjes nuk kanë takuar askënd duke punuar. Dëshmitari N. M., deklaroi se së bashku me L. B. dhe F. M. dy herë kishin dal në vendin e ngjarjes afër rrugës që shpie për në, por nuk kishin takuar askënd, ndërsa veprimet në vendin e ngjarjes i kishte ndërmarr inspektori i ndërtimit F. M..

Për kundër se të akuzuarit e lartcekur në seancën gjyqësorë të datës 14 Shkurt 2023, janë mbrojtur në heshtje, i pandehuri V. S., gjatë deklarimit në seancën gjyqësore të datës 22 Shtator 2022, i njëjti ka pranuar verën penale nga dispozitivi I. i aktakuzës lëndore, po ashtu edhe i pandehuri I. L., ka deklaruar se pronën ia kishte dhënë me qira V..

Prokurorja në vazhdim deklaroi se sa i përket veprës penale, ndërtimi pa leje nga neni 359 par 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, në rastin konkret nga deklaratat e dëshmitareve të lartpërmendur dhe provave materiale, rezultoi se u vërtetua përtej dyshimit se bazuar një fakt i tillë pasi që i akuzuari I.L. si pronar i parcelës dhe A. Th. dhe V.S. si qiramarrës, investitor dhe përgjegjës të drejtpërdrejt, në bashkëveprim kanë filluar ndërtimin e objektit me konstruksion

metalik dhe muratimin e mureve anësore, pa u pajisur me leje ndërtimi. Po ashtu sa i përket veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga nenin 406 të KPRK-së, të pandehurit A. Th.dhe V.S., me verimet e tyre kanë konsumuar elementet e kësaj vepre penale pasi që të njëjtit me datë 10.07.2021 e deri me date 23.07.2021, si qiramarrës, investitor dhe përgjegjës të drejtpërdrejt, në bashkëveprim kanë vazhduar me punimet përkundër paralajmërimit me tabele nga Inspektorët Komunal të Komunës së Kamenicës dhe vendosjes së shiritit zyrtar përreth objektit, të njëjtit kanë vazhduar punimet e ndërtimit të objektit afarist duke e hequr-dëmtuar shiritin zyrtar dhe atë pa i përfill dispozitat ligjore për të u pajisur me leje ndërtimi, e që me këto veprime të kundërligjshme kanë rrezikuar sigurinë e përgjithshëm që kanë të bëjnë me rregullat e ndërtimit. E gjithë ky dyshim ka mbështetje në provat personale që u elaboruan me lartë si dhe në provat materiale si në shkresat e lëndës. Andaj, nga kjo që u tha më lartë, i propozon gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtor dhe t’iu jepet një dënim meritator sipas ligjit.

Mbrojtësi me autorizim i të akuzuarit A. Th., av.Selami Rexhepi, në fjalën përfundimtare deklaron se, sipas aktakuzës lëndore i pandehuri A. Th., akuzohet për kryerjen e veprave penale në mënyrën, kohën, vendin dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin nën I dhe II të aktakuzës lëndore. Prokuroria e shtetit sipas aktakuzës ka propozuar një seri provash materiale, e po ashtu gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor janë dëgjuar edhe dëshmitarët e këtij rasti, A. M., L. B. dhe F. M.. Nga të gjitha këto prova e më konkretisht po që se i referohemi deklaratës së dëshmitarit të parë A. M., në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.07.2023, i njëjti ka deklaruar “se unë kam qenë prezent kur është marrë në pyetje i pandehuri Idriz L.lidhur me këtë çështje penale, i njëjti deklaron se lidhur me këtë çështje nuk i kujtohet asgjë pasi që ka kaluar një kohë e gjatë, i kujtohet se i pandehuri I. ka deklaruar se tokën ia ka dhënë diku me qira, ndërsa në tokën e tij ka ndërtuar dikush tjetër një objekt, por sa më kujtohet në atë tokë nuk ka pasur asgjë të ndërtuar dhe se ka qenë zonë neutrale”, por i njëjti nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes. Nga përmbajtja e kësaj deklarate rezulton se e njëjta lidhur me rastin konkret nuk ka kurrfarë relevance nga se nuk ofron kurrfarë dëshmie konkrete as në lidhje me akuzën e të pandehurit A. në drejtim të veprës penale të ndërtimit pa leje, e as të veprës penale të heqjes apo dëmtimit të vulave zyrtare.

Mbrojtësi i të akuzuarit A., po ashtu thekson se edhe nga përmbajtja e deklaratave të dëshmitarëve, L. B., N. M. dhe F. M., nuk është vetëtuar se i njëjti në çfarë do mënyrë të ketë ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet, përkatësisht në asnjë moment as nuk përmendet fare, por as nuk është identifikuar, apo të jetë

hasur në vend punishte duke punuar, investuar e aq më pak me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i njëjti ka hequr apo dëmtuar shiritat në këtë objekt. Po ashtu prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare thirret në prova materiale, në procesverbalet të cilat inspektorët komunal i kanë hartuar me rastin e daljes në vendin e ngjarjes si dhe shiritimit të objektit, mirëpo po që se me kujdesin e duhur, analizohet përmbajtja e të njëjtave rezulton se nuk ka asnjë dëshmi, provë të vetme materiale me të cilën do të argumentohet fakti se i pandehuri A. Th. të ketë ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të veprave penale për të cilat akuzohet. Andaj mbi bazën e të cekurave si më lartë i propozon gjykatës që konform nenit 363 par.1 pika 3 KPPRK-së, të merr aktgjykim lirues nga se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari A.Th.ti ketë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës lëndore.

I akuzuari **A. Th.**, në fjalën përfundimtare deklaron se, e përkrah në tërësi fjalën e avokatit të tij dhe kërkon nga gjykata që ta liroj nga përgjegjësia penale, sepse nuk e ndjen veten fajtor për veprat penale për të cilat akuzohem.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit V. S., av.Granit Mavriqi, në fjalën përfundimtare deklaron se konsideron në këtë çështje penale juridike aq shumë ka argumente që e argumentojnë pafajësinë e të akuzuarit V. S., por elaborimi i së cilës provë veç e veç do të merrte kohë. Sa i përket veprës penale nga neni 406 të dispozitivit II të aktakuzës për heqjen apo dëmtimin e vulave, me dy fjali vërtetohet pafajësia e të akuzuarit, sepse asnjë dëshmitarë që u dëgjuar në këtë sallë gjykimi nuk ia drejtoi gishtin dhe nuk tha se e ka parë V. S. duke i hequr shiritat e vendosur nga inspektorati. Sa i përket veprës penale nga dispozitivi i I, të aktakuzës me të cilën vepër akuzohet V.S., nga prokurorja e shtetit u përmend se në shkresat e lëndës janë disa foto, por në ato foto askund nuk shihet i akuzuari V., pra në vendin ku pretendohet se është ndërtuar pa leje, nuk shihen punëtorët, që mund ta qojë një ndërlidhje me të akuzuarin V..

Po ashtu as dëshmitarët, L. B., N.M. dhe F. M., asnjëri nga ta nuk deklaroj se këtë ndërtim e ka bërë i akuzuari V.S., ndërsa sa i përket pretendimit të prokurorisë se i akuzuari dhe të tjerët e kanë pranuar veprën penale në një fazë të mëhershme, ligji këtë të drejtë ia njeh edhe me pranuar edhe mos me pranuar fajësinë, mirëpo në rast se nuk ka fakte dhe prova tjera mbështetëse edhe tani me pranuar fajësinë i akuzuari V., gjykata është e obliguar mos me ia pranuar fajësinë dhe mos me shpall fajtor pasi që me një provë të vetme askush nuk mund të shpallet fajtor, andaj kërkon nga gjykata që akuzuarin V. S.ta shpall të pafajshëm.

I akuzuari **V. S.**, në fjalën përfundimtare deklaron se, e përkrah në tërësi fjalën e avokatit të tij dhe kërkon nga gjykata që ta liroj nga përgjegjësia penale sepse nuk e ndjen veten fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit I.L. av.Shefqet Rexha, me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaroi se aktakuza aktuale në strukturën e saj përmbajtjesore përmban një specifikim të përgjithësuar dhe se nga përmbaja e tillë e demonstruar mungon përshkrimi i veprimeve konkrete diskriminuese si parakusht për sajimin e figurës së veprës penale. Duhet pasur parasysh se figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme një nga një, si dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penale juridike. Nga kjo që është vënë pah në mënyrë të qartë rezultoi se çdo vepër penale i ka elementet e veta të posaçme. Për të demonstruar këtë vlen të theksohet se akuzat nuk saktëson asnjë provë e cila në mënyrë specifike do të vërtetonte pretendimin se a kemi të bëjmë me të vërtetë me vepër penale të, Ndërtimit pa leje dhe nëse kemi nga kush është bërë ky ndërtim!! Duhet pasur parasysh se i akuzuari I. L. edhe gjatë procedurës parapenale si në deklaratën e dhënë në prokurori, por edhe në seancat gjyqësore e ka mohuar në tërësi të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi ai pronën vetëm se kishte dhënë tokën me qira -në shfrytëzim. Është me rëndësi për Gjykatën se i akuzuari është pronarë faktik i parcelës në të cilën ishte ngritur ky objekt, por pa lejen dhe pëlqimin respektivisht pa dijeninë tij , por se i njëjti vetëm e kishte dhënë me qira dhe ne asnjë mënyrë dhe për asnjë moment nuk ka ndërmarrë asnjë veprim as në ndërtim, as në dëmtim apo heqje të shenjave apo diçka të ngjashme. Po ashtu thekson se duhet pasur parasysh se edhe në dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria, si Inspektori i Ndërtimit z.F. M., shefi i Inspektionit z.Liridon Beqiri të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të cilët deklaruan se “nuk kemi hasur në asnjë person gjatë kontrollit tonë në vendin e ngjarjes” që le të kuptohet se me asnjë fakt –provë-dëshmi nuk është vërtetuar se i pandehuri I. L. ka rënë ndeshë me ligjin, pasi ai nuk ka ndërtuar asgjë në pronën e tij. Andaj i propozon gjykatës që të pandehurin, I. L. nga ta liroj nga përgjegjësia penale në mungesë të dëshmive, respektivisht fakteve/provave bindëse të cilat do ta vërtetonin një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar me aktin akuzues.

I akuzuari **I.L.**, në fjalën përfundimtare deklaroi se, e përkrah në tërësi fjalën e avokatit të tij dhe kërkon nga gjykata që ta liroj nga përgjegjësia penale sepse nuk e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke pasur parasysh se të akuzuarit, A. Th., V. S. dhe I. L., nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës, e me qëllim të vërtetimi dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e të gjitha provave të propozuara nga ana e prokurorisë së shtetit sipas aktit

akuzues, si ato personale, ashtu edhe ato materiale, edhe atë: ka dëgjuar dëshmitarët A.M., L. B., N. M. dhe F. M., si dhe provat materiale si në shkresat e lëndës.

Nga deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit, **A. M.**, zyrtar policor gjykata vërtetoi faktin se i njëjti në Stacionin e policisë e ka intervistuar të akuzuarin I. L. lidhur me këtë çështje penale, mirëpo pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i kujtohet saktësisht se çfarë ka deklaruar. I kujtohet se i njëjti ka deklaruar se e ka dhënë tokën me qira, ndërsa në atë pronë të tij dikush tjetër e ka ndërtuar një objekt, po ashtu nuk i kujtohet se për çfarë qëllimi e ka dhënë pronën në shfrytëzim, po ashtu nuk e dinë se a ka pasur të ndërtuar, apo të nisur diçka për t'u ndërtuar në atë pronë, sepse ai nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes, por me sa dinë ai në atë tokë nuk ka pasur të ndërtuar diçka sepse ka qenë në zonën neutrale.

Nga deklarata e dëshmitarit **L. B.**, Shef i inspektionit, në Inspektoratin komunal në Kamenicë, gjykata vërtetoi faktin se të njëjtit data nuk i kujtohet, por i kujtohet se ditën kritike si inspektorat komunal kanë dalë në vendin e ngjarjes në mes të, në vendin e ngjarjes nuk e kanë hasur askënd, kishte qenë duke u punuar një objekt montazh. Së bashku me te kanë qenë edhe Inspektori i ndërtimit F. M. dhe N. M., e po ashtu në shoqërim me ta kanë qenë edhe disa polic. Dëshmitari deklaroi se herën e parë kur kanë qenë në vendin e ngjarjes objekti ka qenë në gjendje fillestare, sepse në një pllakë betoni e cila ka qenë e qitur më parë kishin qenë disa ceva të metaltë për konstruksion, por pasi që nuk ishte askush në vendin e ngjarjes, e kanë hartuar një proces, pastaj edhe një vendim me të cilin e kanë obliguar me i ndërpre punimet, por pasi që nuk kishin kujt t'ia dorëzojnë vendimin, të njëjtin e kanë lënë në vend punishte. Të dhënat e ngastrës kadastrale i kanë marrë në zyrën kadastrale në Kamenicë, me ç rast e kanë shirituar vendin. Ndërsa herën e dytë kur kanë shkuar në vendin e ngjarjes me sa i kujtohet vetëm objekti montazh kishte qenë i përfunduar. Në bazë të fletë posedimit që kanë siguruar në Zyrën kadastrale në Kamenicë pronar i asaj ngastre ka qenë Sh. K. nga andaj edhe kallëzimin penal e kanë orientuar ndaj tij në bazë të shënimeve që i kanë marrë në kadastrë, me të cilin asnjëherë nuk kanë kontaktuar, por thekson se ata nuk e dinë se kush ka qenë shfrytëzues i asaj ngastre edhe përkundër faktit se dy tre herë janë shkuar me polici, por askënd nuk e kanë gjetur në vendin e ngjarjes, edhe ate as pronarin si as punëtorët. Dëshmitari në vazhdim deklaroi se pastaj kanë marrë një vendim dhe e kanë rrënuar atë objekt montazh, po ashtu edhe kur e kanë rrënuar atë objekt në vendin e ngjarjes askush nuk ka qenë prezent dhe askush nuk ka shpreh pakënaqësi për rrënimin e atij objekti. Po ashtu deklaroi se nuk e dinë se kush i ka hequr shiritat të cilat i kanë vendosur në vendin e ngjarjes.

Nga deklarata e dëshmitarit **N.M.**, Inspektor i Veterinarisë, gjykata vërtetoi faktin se së bashku me L. B. dhe F. M. kanë qenë në vendin e ngjarjes në mes të fshatit Novosellë dhe

Karaqevë, dhe nuk e din se për cilin objekt është i ftuar për të dëshmuar, sepse me profesion është veterinar dhe ai shkua vetëm në asistencë të inspektorit të ndërtimtarisë dhe shefit të inspeksionit. Dëshmitari deklaroi se i kujtohet se në vendin e ngjarjes kanë qenë dy herë dhe si herën e parë ashtu edhe në herën e dytë nuk e kanë hasur askënd, ndërsa në vendin e ngjarjes kanë hasur mjete të punës dhe material ndërtimor por jo edhe persona. Të gjitha veprimet në vendin e ngjarjes i ka ndërmarrë inspektori i ndërtimit F.M., ndërsa ai vetëm ka qenë në asistencë të tij.

Nga deklarata e dëshmitarit **F. M.**, ish Inspektor i Ndërtimit në komunën e Kamenicës, i cili lidhur me rastin deklaroi se , data nuk i kujtohet por pasi që kanë marrë informatë se në fshatin Karaqevë, në vendin ku u ndërtonin kazinotë se është duke u ndërtuar një objekt. Së bashku Kryeshëfin e Inspektoratit komunal kanë dalë në vendin e ngjarjes, në hyrje të fshatit Karaqevë kanë hasur në një objekt që kishte qenë duke u ndërtuar, mirëpo nuk kanë hasur në asnjë person gjatë kontrollit, me çrast kanë marrë masat për shiritim të objektit, *po ashtu i është vendosur edhe pllaka – shenja nga inspektoriat komunal*, por pasi që nuk kanë hasur në asnjë person në ndërtim, vendimet i kanë adresuar në pronarin e tokës, pasi që pronarin e tokës e kanë gjetur në bazë të regjistrave kadastral. Në vendin e ngjarjes kanë vërejtur se kishte qenë pllaka e betonit dhe kishte filluar konstruksioni metalik dhe sipas tij për fillimin e punëve ndërtimore nevojitet leja ndërtimore, ndërsa pronari ose investitori duhet të marrin leje paraprakisht për kryerjen e punëve, kurse punë kryerësi duhet të ketë kontratë të noterizuar për kryerjen e punëve. Kanë lëshuar një vendim për ndërprerjen e punëve në emër të pronarit të tokës, Dëshmitari po ashtu deklaroi se me siguri edhe njëherë kanë qenë në vendin e ngjarjes, për të verifikuar se a kanë vazhduar me punime dhe në bazë të fotove që i kanë bërë në vendin e ngjarjes shihet se kur kanë dalë për herë të dytë vërehej se ishin vazhduar punimet në të cilën ishin ndërtuar dy mure anësore dhe konstruksioni metalik i kulmit të objektit. Po ashtu edhe gjatë inspektimit që i kanë bërë herën e dytë askënd nuk e kanë gjetur në vendin e ngjarjes, ndërsa në anën tjetër punimet vazhdonin. Andaj thekson se edhe për këtë arsye e kanë bërë kallëzimin penal në emër të pronarit të tokës, sepse sipas ligjit të ndërtimit është përgjegjëse për tu pajisur me leje ndërtimi, nëse lejohet në atë vend. Dëshmitari në vazhdim deklaroi se si herën e parë po ashtu as herën e dytë askënd nuk e kanë takuar në vendin e ngjarjes duke punuar e po ashtu askënd nuk e kanë parë duke i hequr shiritat dhe nuk e di se kush i ka hequr shiritat.

Të akuzuarit, A. Th., V. S. dhe I. L., mbrojtjes e tyre e paraqesin në heshtje dhe nuk dojnë që të deklarohen lidhur me këtë çështje.

Gjykata me kujdes të veçantë vlerësoi deklaratat e dëshmitarëve, A. M., L. B., N. M. dhe F. M., të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, fjalët përfundimtare të paraqitur nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, si dhe provat materiale si në shkresat e lëndës, të cilat prova i ka analizuar dhe vlerësuar një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës, në bazë të cilave prova erdhi në përfundim se nuk është kontestuese fakti se në mes të fshatit Karaqevë e Poshtme dhe fsh. Novosellë, afër rrugës së fshatit Breznicë ka filluar dhe është ndërtuar një objekt montazh pa leje ndërtimi dhe inspektorët komunal me rastin e inspektimit i kanë vënë shiritin për ndërprerjen e punimeve, e më pastaj kanë marrë vendim dhe e kanë rrënuar atë objekt montazh. Por me këto prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se të akuzuarit, A. Th., V. S. dhe I. L., të kenë kryer veprën penale, Ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, e po ashtu nuk është vërtetuar se të akuzuarit A. Th. dhe V. S., të kenë kryer veprën penale, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata po ashtu me kujdes të veçantë vlerësoi edhe pretendimin e fjalës përfundimtare të prokurores së shtetit dhe vërteton se prokuroria nuk ka arritur të ofroj prova të mjaftueshme me të cilat plotësohet standarti i të provuarit në një procedurë penale.

Ndërsa faktin që prokurorja e shtetit e potencoj në fjalën përfundimtare, se i pandehuri I.L., në deklaratën e dhënë në polici e ka pranuar veprën penale, po ashtu edhe V. S. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pikës I. të dispozitivit të aktakuzës, gjykata duke pasur parasysh faktin se të njëjtit në gjykatë mbrojtjen e tyre e kanë paraqitur në heshtje, ndërsa në fjalën përfundimtare nuk e kanë pranuar fajësinë, atëherë për të akuzuarin I.L. duke vepruar konform nenit 257 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mundi të njëjti ta shpalli fajtorë, duke u mbështetur vetëm në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në polici. E po ashtu gjykata nuk mundi të akuzuarin V. S. ta shpalli fajtor vetëm për faktin se i njëjti në shqyrtimin fillestar e kishte pranuar fajësinë, sepse gjykata duke vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 242, paragrafi 2 të KPPRK-së, të njëjtit nuk i ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar, për faktin se gjykata nuk është bindur se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, sepse pranimin e fajësisë e kishte bërë vetëm pas konsultimit paraprak që kishte me dy të akuzuarit e tjerë jashtë sallës së gjykimit.

Gjykata vlerëson se përgjegjësia penale duhet të provohet, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtë për drejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, prandaj edhe në të drejtën penale vlen parimi “In Dubio Pro Reo”, pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtat e tij, në mbështetje të nenit 3, parag.2 të KPPRK-së.

Meqenëse nuk është vërtetuar se të akuzuarit, A.Th., V. S. dhe I. L. të kenë ka kryer veprën penale, në bashkëkryerje, Ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3 lidhur paragrafin 2, e në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, si dhe as të akuzuarit A. Th. dhe V. S., veprën penale, në bashkëkryerje, Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 406, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i ka liruar nga akuza.

Pala e dëmtuar Komuna e Kamenicës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 453, paragrafi 1, lidhur me nenin 449 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate .

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së, palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2022:020373, 29.03.2024

Numri i lëndës: 2022:020373
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05528259

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi, d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykata Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.